


UDHËZUES PËR APLIKIM

PËRKRAHJE PËR ANËTARËSIM NË RRJETE
RAJONALE/NDËRKOMBËTARE

Bashkëfinancuar nga:



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC





Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me qëllim të fuqizimit të rolit të shoqërisë civile në zhvillimin e demokracisë, ofron përkrahje financiare për anëtarësim të OJQ-ve në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare, për të nxitur veprimet e përbashkëta me partnerët rajonale e ndërkombëtare.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Organizatat joqeveritare vendore, përveç kategorive të përjashtuara si më poshtë:

- Përkundër statusit të tyre juridik, klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore ose organizatat fetare, që janë të regjistruara si OJQ, nuk janë synim i granteve të KCSF-së.
- Ngjashëm, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme për të cilat është e qartë që kanë aftësi financiare për të mbuluar shpenzimet e organizatës së tyre ose për të përkrahur aktivitetet e tyre, nuk janë synim i granteve të KCSF-së.
- Degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

KRITERET PËR APLIKIM

Të gjitha aplikimet do të shqyrtohen individualisht dhe do të vlerësohen nga Komisioni Vlerësues bazuar në këto kritere:

- Përfitimet që do të ketë organizata nga ky anëtarësim;
- Përputhshmëria e misionit dhe fushëveprimtarisë së organizatës aplikuese me misionin dhe fushëveprimtarinë e rrjetit në të cilin kërkohet anëtarësimi.
- Të mos jenë të udhëhequra ose të menaxhuara nga Persona të ekspozuar politikisht (PEP).¹
- Pranon dhe përkushtohet t'i zbatojë Vlerat themelore për grantet e EJA.²
- Në mes aplikacionesh që plotësojnë njëjtë kriteret e mësipërme, përparësi do të kenë organizatat:
 - Të cilat nuk mund të mbulojnë pagesën e anëtarësisë nga ndonjë burim tjetër;
 - Organizatat që nuk kanë pasur me herët grant për rrjetëzim.

ÇKA FINANCOHET?

Pagesa e anëtarësisë në rrjetet rajonale/ndërkombëtare (membership fee).
Shpenzimet e transferit bankar.

¹ Për më shumë rreth kufizimeve në lidhje me personat e ekspozuar politikisht (PEP), shih formularin e aplikimit. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara të deklarojnë se asnjë person në pozicionet drejtuese, sipas listës dhe përcaktimit të Personave të ekspozuar politikisht, të paraqitura në formularin e aplikimit, nuk bien nën këtë kategori.

² Për më shumë rreth Vlerave themelore për grante të EJA, shih formularin për aplikim. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara që t'i pranojnë dhe të përkushtohen që do t'i përmbahen Vlerave themelore për grante të EJA.

NUMRI I APLIKIMEVE DHE GRANTEVE PËR APLIKANTË

Aplikantët mund të jenë përfitues të grantit për rrjetëzim një herë brenda vitit.

KOHËZGJATJA

Përkrahja do të mbulojë shpenzimet e anëtarësimit vetëm nga momenti i aprovimit të saj e tutje. Në kuadër të kësaj, përkrahja nuk do të mbulojë shpenzimet për anëtarësimet e realizuara më herët, përfshirë këtu shërbimet e pranuar gjatë periudhave ose muajve të vitit përpara pranimit të përkrahjes. Po ashtu, nuk do të përkrahen aplikimet për rrjetëzim që dorëzohen pas datës 1 tetor të vitit kur synohet anëtarësimi.

PËRJASHTIMET

- Në kuptimin e kësaj përkrahjeje, anëtarësimi në rrjete nënkupton vetëm pagesat e anëtarësimit për organizatat joqeveritare dhe përjashtohen anëtarësimet në rrjetet/platformat profesionale ku anëtarësimi dhe pagesa bëhet për individë, pavarësisht që ata individë janë përfaqësues të organizatave që aplikojnë, në fushat të cilat mbulon organizata. Ndonëse në raste të tilla përfitimi është edhe i organizatës, ai mund të mbetet dytësor në raport me përfitimet profesionale individuale dhe del nga kuptimi i këtyre granteve për rrjetëzim.
- Nuk bëhet pagesa e anëtarësimeve për vitet paraprake.
- Nuk bëhet rimbursim i anëtarësive të paguara para informimit për vendimin pozitiv për aplikacionin.
- Këtu hyjnë edhe organizatat që kanë qenë përfitues të këtyre granteve dhe gjatë aplikimit për grant të ri nuk arrijnë të dëshmojnë pjesëmarrje në aktivitete, bashkëpunime ose dëshmi të përfitimeve që ka pasur organizata nga granti për rrjetëzim.
- Nuk bëhet pagesa e faturave të lëshuara që nuk janë në emër të organizatave aplikuese.
- Grantistët institucional të mbështetur nga EJA Kosovë nuk mund të aplikojnë për përkrahje nga kjo thirrje.

PËRKRAHJA

Shuma maksimale e përkrahjes është 1,000 EUR për anëtarësi.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikimi bëhet përmes [sistemit online të aplikimit](#). Udhëzimet për regjistrim dhe përdorim të sistemit të aplikimit mund t'i gjeni në [webfaqe](#). Në rast se hasni vështirësi ose keni nevojë për sqarime shtesë sistemit të aplikimit, ju lutemi ndjehuni të lirë të na kontaktoni përmes email-it ose telefonit.

Dokumentet që duhet t'i dorëzoni përmes sistemit online të aplikimit:

- Formularin e aplikimit.
- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së lëshuar nga Departamenti për OJQ.
- Në rastet kur aplikohet për vazhdim të anëtarësisë ekzistuese, çfarëdo dokumenti që dëshmon anëtarësinë (pagesë të anëtarësisë paraprake, faturë, email, listë zyrtare të anëtarëve, weblink etj).
- Në rastet kur aplikohet për anëtarësi të re, çfarëdo dokumenti që dëshmon gatishmërinë e rrjetit për pranim të organizatës, (faturë, email, zotim, etj).
- Në rast që organizata ka qenë përfituese e grantit për rrjetëzim, dëshmi të përfitimeve që ka pasur organizata e që mund të jenë foto ose komunikime që dëshmojnë pjesëmarrje në takime/diskutime në kuadër të rrjetit, dhe të ngjajshme.
- Në rast që shuma e anëtarësimin në rrjet kalon shumën maksimale të lejuar në këtë thirrje, dëshmi të bashkëfinancimit nga burim/e të tjera (p.sh. email, letër të zotimit, kontratë, etj).

AFATI PËR APLIKIM

Aplikimi për grante për rrjetëzim do të jetë i hapur gjatë gjithë kohës, deri në shpenzim të fondeve.

Aplikantët do të njoftohen rreth vendimit të Komisionit Vlerësues më së voni 30 ditë nga data e aplikimit.

Të gjitha pyetjet lidhur me aplikimin për grante nga kjo skemë mund të dërgohen në e-mailin aja@kcsfoundation.org.

NËNSHKRIMI I KONTRATËS

Në rastet e përkrahjes së aplikacionit për anëtarësim, pas pranimit të përgjigjes pozitive, nga organizata aplikuese do të kërkohet që të dërgohen informatat e nevojshme për kontraktim, ku hyjnë të dhënat e përfaqësuesit ligjor të organizatës dhe numri i llogarisë bankare të organizatës. Shuma e grantit transferohet te organizata pas nënshkrimit të kontratës.

PËRMBYLLJA E KONTRATËS

- Pas nënshkrimit të kontratës dhe pranimit të shumës, organizata përfituese duhet të dorëzojë dëshminë e transferit të shumës te rrjeti i cili synon të anëtarësohet.
- Në rastet kur ka mbetje nga shuma e kontraktuar dhe shuma e transferuar te rrjeti në vlerë më shumë se 10 EUR, ajo mbetje duhet të kthehet te KCSF.